



PËRFSHIRJA E TË RINJVE DHE  
SHOQËRISË CIVILE NË PROCESIN  
ANËTARËSIMIT TË SHQIPËRISË NË  
BASHKIMIN EVROPIAN.



# RAPORT MONITORIMI

Maj-Korrik 2022



AUTOR  
**RENIS META**

QENDRESA  
QYTETARE



**NED**

NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)

## Tabela e përmbajtjes

- Hyrje
- Vështirësia në hapjen e negociatave dhe skepticizmi kundrejt Shqipërisë në rrafshin ndërkombëtar
- Nisma e Këshillimit Kombëtar apo “kuvendimi popullor” me qytetarët.
- Samiti BE-Ballkani Perëndimor
- Post hapjes së negociatave
- Manifestimi “egos politike” në një ditë historike dhe mungesa e konsensusit politik
- Mekanizmat për përfshirjen e Shoqërinë Civile
- *Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian*
- *Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian*
- Të rinjtë dhe organizmat për përfshirjen e tyre
- Konkluzione
- Rekomandime
- Referenca

## Hyrje

Në Dhjetor të vitit 2002, Këshilli Evropian në Kopenhagen konfirmoi perspektivën Evropiane dhe mbështetjen për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Shqipërinë si kandidate potenciale për të qenë anëtare të Bashkimit Evropian.<sup>1</sup>

Në prill të vitit 2009 Shqipëria paraqiti kërkesën e saj zyrtare për anëtarësim në BE dhe në tetor të vitit 2012, Komisioni Evropian rekomandoi që Shqipërisë t'i jepet statusi i kandidatit në BE, me kusht që të plotësohen reformat kyçe në fushat e gjyqësorit, të administratës publike dhe shtetit të së drejtës. Pas mbledhjes së Këshillit në qershor të 2014 në Bruksel, Shqipërisë iu dha statusi i vendit kandidat nga BE dhe prej asaj periudhe Shqipëria dhe qytetarët e saj kanë kaluar në një kalvar të gjatë e të mundimshëm në pritje të hapjes së negociatave për anëtarësim në BE.

Më shumë se kurrë kjo perspektivë dukej e zbehur prej kohës dhe humbjes së besimit në këtë proces dhe nga viti 2014 dukej se progresi i Shqipërisë, reformat e ndërmarra dhe agjenda e ndjekur nga qeveria pati rezultuar të jetë jo e sukseshme për të hapur negociatat dhe mbajtur konferencën e parë ndërqeveritare. Tetë vite më pas, Shqipëria do të hapte negociatat me Bashkimin Evropian në korrik të vitit 2022 dhe do të mbante konferencën e parë ndërqeveritare.

Procesi për anëtarësim është shoqëruar nga një paqëndrueshmëri e vazhdueshme dhe agjenda e jashtme e Shqipërisë në vitet e fundit është karakterizuar nga luhajtje të vazhdueshme të ardhura më së shumti nga faktori i brendshëm dhe situata e tensionuar në “habitatit politik”. Përpos problemeve të brendshme, po ashtu dhe linja e ndjekur vitet e fundit nga BE ka qenë më e ngurtë dhe prej vendeve kryesore të BE-së mbi Shqipërinë ka patur periudha “të nxehta” skepticizmi.

<sup>1</sup> Këshilli i Bashkimit Evropian. (2003). Presidency Conclusions - Copenhagen, 12 and 13 December 2002. Fq 6.

## Vështirësia në hapjen e negociatave dhe skepticizmi kundrejt Shqipërisë në rrafshin ndërkombëtar

Një erë ndryshimi dhe shpresdhënëse po frynte në Shqipëri por jo në Europë, kur në vitin 2018 u duk se Shqipëria kishte hedhur hapin e rëndësishëm në çeljen e negociatave dhe mbajtjen e Konferencës së Parë Ndërqeveritare. Duke u kthyer pas në kohë, në atë periudhë Kryeministri gjatë komunikimit të tij publik pas publikimit të raportit të Komisionit Evropian deklaroi se se Shqipëria sapo kishte hapur një kapitull të ri, të historisë së saj si shtet. Kryeministri Rama do të pohonte me krenari se Shqipëria ia doli “këtij provimi të stërvështirë” dhe se vendi ka tjetër status në arenën ndërkombëtare.<sup>2</sup>

Pas këtij optimizimi që nuk do të kurorëzohej me sukses, Shqipëria do të përballlej me një stuhi të ashpër lobimi në rrafshin ndërkombëtar. Vendi do të ishte gjithnjë e më larg hapjes së negociatave me BE-në si pasojë e skepticizmit që rrethonte Bashkimin Evropian dhe kundërshtimit të hapur të vendeve si Holanda, Franca e më pas vendosjes së kushteve nga Gjermania për hapjen e negociatave. Gjatë kësaj periudhe Shqipëria u përball me rezistencën e parlamentit Holandez, që në asnjë moment nuk e fshehu skepticizmin për hapjen e negociatave me Shqipërinë duke vlerësuar përpjekjet e Shqipërisë si të pamjaftueshme për një përgjigje pozitive ndaj hapjes së negociatave. Më tej, në vitin 2019 Shqipëria u gjend përballë kushteve të vendosura nga Bundestagu Gjerman që e shihnin Shqipërinë ende larg të qenit gati. Narrativa qeverisëse do ti quante rekomandimet e Bundestagut gjerman, jo kërkesa apo kushte që vinin në sagën e kërkesave për të garantuar pavarësinë e gjyqësorit, luftën kundër korrupsionit dhe lirinë e shtypit.

<sup>2</sup> Faqja zyrtare e Kryeministrit. Aksuesuar në: <https://kryeministria.al/newsroom/sot-fitoi-shqiperia/>

Një tjetër pengesë në rrugën e Shqipërisë do të ishte vetoja Bullgare e vendosur ndaj Maqedonisë së Veriut. Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut duhej të nisnin bisedimet e anëtarësimit me bllokun në fund të vitit 2020, por Bullgaria do të bllokonte hapjen e bisedimeve zyrtare për shkak të një mosmarrëveshjeje mbi historinë dhe gjuhën me Maqedoninë e Veriut. Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut ishin të pozicionuara së bashku për sa i takon procesit të anëtarësimit të tyre dhe mbajtjes së konferencës së parë ndërqeveritare me BE-në. Vetoja e Bullgarisë ndaj kësaj të fundit nënkuptonte se mbajtja e konferencës së parë ndërqeveritare, e cila shënon zyrtarisht nisjen e procesit të anëtarësimit, do të mbetej e shtyrë për një kohë të pacaktuar.

Ndonëse vetoja e Bullgarisë ishte një problem aktual që vonoi hapjen e negociatave duhet pasur në konsideratë se për tetë vitë kanë qenë pengesat e brendshme që kanë cënuar progresin e vendit dhe hapjen e negociatave. Shqipëria ishte “peng” i vetvetes këto vite, problematikat e lidhura me sundimin e ligjit, korrupsionin e lartë, të drejtat e njeriut dhe lirinë e medias, etj., janë pasqyruar pothuajse në të gjithë raportet e organizmave të BE-së dhe organizmave ndërkombëtare të cilat monitorojnë ecurinë dhe progresin e proceseve demokratike të vendeve si Shqipëria që aspirojnë integrimin në familjen europiane.

### **Nisma e Këshillimit Kombëtar apo “kuvendimi popullor” me qytetarët.**

Nisma e Këshillimit Kombëtar apo “kuvendimi popullor”, nën moton “Le të dëgjojmë njëri-tjetrin”, udhëhoqi narrativën qeverisëse për bashkëqeverisje në fillimin e vitit 2022. Kjo nismë referuar qeverisëse u zhvillua për të dëgjuar mendimin e qytetarëve mbi çështje me rëndësi strategjike për vendin që prekin ekonominë, drejtësinë, apo marrëdhëniet e jashtme.

Qeveria pa të nevojshme marrjaen e mendimit të qytetarëve shqiptarë mbi agjendën e jashtme që duhej të ndiqte Shqipëria në lidhje me integrimin e saj në Bashkimin Evropian dhe grupimin së bashku me Maqedoninë e Veriut.

Mbi gjysmë milion qytetarë u bënë pjesë e anketës “Këshillimi Kombëtar”. Pjesë e njëmbëdhjetë çështjeve të drejtuara qytetarëve ishte dhe anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe rrugës që duhej të ndiqte Shqipëria lidhur me grupimin së bashku me Maqedoninë e Veriut.<sup>3</sup>

*Pyetja 11 “Anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian është i lidhur me anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut. Ka njerëz që thonë se aplikimi i Shqipërisë për anëtarësimin në BE duhet të ndahet nga ai i Maqedonisë së Veriut, që vendi ynë të vlerësohet për meritat e veta. Të tjerë thonë që duhet të vazhdojmë të presim Maqedoninë e Veriut. Si mendoni ju”*

67 % e qytetarëve shqiptar (343,420 persona) janë përgjigjën pro ndarjes dhe 19% (96,910 persona) janë përgjigjur kundër dhe 14% (72,871 persona – Nuk e di) nuk kishin një opinion të caktuar mbi këtë çështje.<sup>4</sup>

Gjatë komunikimit publik të rezultateve të sondazhit kombëtar me më shumë se gjysmë milioni të anketuar, që tregoi se 67 % donin që rruga e anëtarësimin të dy vendeve të ndryshonte, qeveria shqiptare me në krye kryeministrin pohuan se kursi politik për këtë çështje do të ndryshonte tërësisht, duke nënvizuar marrëdhëniet e mira që Shqipëria kishte me të dy shtetet.<sup>4</sup>

Përgjigjja e marrë nga Këshillimi Kombëtar e shprehu qartë opinionin e qytetarëve shqiptarë mbi rrugën që duhet të ndiqte qeveria. Sa realist mund të konsiderohet një proces i tillë në thelb dhe sa e vlefshme ishte marrja e opinionit të qytetarëve shqiptarë, kur tanimë ishte e qartë se ishte një vendim politik i BE-së për të mos i ndarë dy vendet që shihnin një të ardhme të pandarë, të paktën deri në mbajtjen e konferencës së parë ndërqeveritare. Për më tepër, ndarja e dy vendeve ishte një çështje që në mënyrë indirekte kishte marrë përgjigjen, kur tre vite më

<sup>3</sup> Faqja zyrtare e Platformës Këshillimi Kombëtar. <https://keshillimikombetar.al/>

<sup>4</sup> Faqja zyrtare e Platformës Këshillimi Kombëtar. <https://keshillimikombetar.al/>

parë ishte Shqipëria që do të mbante të “lidhur” pas vetes Maqedoninë e Veriut.

Në ndryshim me qëndrimin e pohuar nga qeveria dhe me atë çfarë rezultoi nga Këshillimi Kombëtar nga kryeministri u ndoq një tjetër rrugë. Kjo do të kulmonte me samitin e BE-së të mbajtur në 23-24 Qershor në Bruksel, me liderin e qeverisë që nuk do të kërkonte që Shqipëria të ndahej nga Maqedonia e Veriut, por do të kishte një përballje të drejtpërdrejtë me palën Bullgare, që do të shënonte një precedent me pasoja diplomatike me palën Bullgare.

Për çështje të tilla të një rëndësie të veçantë për të ardhmen e vendit që aspiron të antarësohet në BE është e rëndësishme që qytetarët e saj të jenë të informuar dhe të qeveria të jetë e gatshme të ndërveprojë si rrjedhojë e përgjegjësisë që mbart për llogaridhënie dhe transparencë në këtë proces të rëndësishëm të vendit.

Këshillimi Kombëtar ka qenë ndër nismat e vetme që në parim ka ofruar një mundësi për qytetarët të jepnin opinionin e tyre mbi agjendën e jashtme, **pavarësisht se më pas vullneti i qytetarëve nuk u kanalizua në vendimmarrje nga qeveria gjatë samitit të Brukselit..**

### Samiti BE-Ballkani Perëndimor

Samiti BE-Ballkani Perëndimor i mbajtur më 23 qershor në Bruksel ishte i një rëndësie të veçantë për rrugën europiane të Shqipërisë dhe për hapjen zyrtare të negociatave që do të pasonte javë pas samitit. Samiti në 23 qershor 2022 në Bruksel mori një rëndësi të veçantë për Ballkanin Perëndimor, sepse për herë të parë kishte një dalje publike të tre krerëve të shteteve të Shqipërisë, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut, vende të cilat janë po ashtu nismëtarët e “Open Balkan”.

Vetë mbajtja e këtij samiti ishte në ekuilibër, kur tre liderët e “Open-Balkan” para mbajtjes së Samitit në Bruksel vendosën ti jepnin zë frustrimit të tyre duke paralajmëruar se mund të vendosnin të bojkotonin samitin në Bruksel pas vendimit të Bullgarisë për të mos

hequr veton ndaj Maqedonisë së Veriut dhe sjelljes që BE kishte pasur me rajonin, për lideret e Open Balkan ky takim nuk do të prodhonte asgjë pozitive për rajonin.

Për herë të parë në historinë e saj Shqipëria do të gjendej në frontin e një “përballje të ftohtë” me Bashkimin Evropian, e veçanërisht Bullgarinë. Deklarata që kalonin linjën e kuqe të ardhura nga frustrimi i gjatë, por të nxituara duke parë që e vetmja alternativë e Shqipërisë është integrimi në Bashkimin Evropian dhe pozicionimi krah aleatëve perëndimor, Ndonëse frustimi për shtyrjen e negociatave ka qënë i madh duke të rikujtojmë se problemet e brendshme kanë qënë po ashtu një arsye e shtyrjes së hapjes së negociatave. Duhet pasur në konsideratë se vendi ynë nuk është i imunizuar nga influenza e vendeve jo mike, përkundrazi, çdo deklaratë jo e kujdeshme apo paqartësi e reflektuar në agjendën e jashtme dhe zbehja e rolit të Bashkimit Evropian në hapësirën e brendshme, do t’u jepte shkas aktorëve joperëndimorë të gjenin hapësira për ta shtrirë më tej ndikimin e tyre në vend.

### Post hapjes së negociatave

Plot tetë vite nga marrja e statusit të vendit kandidat dhe vite pritje, BE i dha Shqipërisë mundësinë për të ndërmarrë hapin e madh, dhe nisur bisedimet zyrtare në tryezë me Bashkimin Evropian, hapi i fundit drejt anëtarësimit të plotë.

Hapi i parë është korniza negociuese që i hap rrugën “screening” apo përafrimit të legjislacionit. Negociatat e nivelit teknik do nisin pas përcaktimit të kuadrit negociues. Ritmi i negociatave varet nga shpejtësia e reformave dhe përafrimi i legjislacionit të vendit me atë të BE-së. Procesi i “screening”, nën monitorimin e Komisionit Evropian është një vëzhgim i thellë i të gjitha fushave specifike. Nëpërmjet kornizës negociuese evidentohet se se çfarë duhet plotësuar për të hapur dhe mbyllur grup-kapitujt e negociatave.



Çfarë është risi dhe në të njëjtën kohë sfidë për Shqipërinë është metodologjia e re, që do vijojë të zbatohet me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut e riformatuar në formën e 6 grup-kapitujve tematikë. Shqipëria tanimë duhet të tregojë maturitet dhe të vijojë të zbatojë më tej me prioritet reformat e sundimit të ligjit, pavarësisë së drejtësisë, të drejtave themelore, që kanë një rëndësi të veçantë në metodologjinë e re të zgjerimit të BE-së, kapituj që hapen të parat dhe mbyllen të fundit.

Përafrimi i legjislacionit, hapja dhe mbyllja e kapitujve kërkon një angazhim deri në detaje, një punë tejet voluminoze ku është e nevojshme një administratë dhe institucione që garantojnë zbatimin e ligjeve në terren dhe kjo kërkon shumë kohë dhe përpjekje. Ritmi i negociatave do të varet nga shpejtësia e reformave, si dhe forcimi i institucioneve demokratike, i administratës publike mbeten sfida kryesore. Me shqetësim shihet mungesa e njerëzve të kualifikuar në administratën publike për të qenë në nivelin e negociatave teknike me vendet e BE.

Komisioni Evropian ka cekur qartë rëndësinë për të qenë në hapin e duhur në zhvillimin e negociatave të anëtarësimit me BE-në, vendi duhet të risë kapacitetin e burimeve njerëzore dhe financiare të dedikuara për anëtarësimin në BE në të gjithë administratën (Komisioni Evropian, 2021, fq.12).

Hapja e negociatave kërkon një transformim në dimensionin politik, ekonomik dhe social të vendit. Duhet të jemi të vetëdijshëm se hapja e negociatave është një shtysë dhe motiv, por nuk siguron cilësinë e reformave të thella shtetformuese, ndaj qeveria duhet të jetë e gatshme dhe e zotuar në përmbushjen e detyrimeve që paraqet ky proces.

**Manifestimi “egos politike” në një ditë historike dhe mungesa e konsensusit politik**

Për Komisionerin e Zgjerimit në BE, Oliver Varhelyi hapja e negociatave, do të sjellë një proces të gjatë që do të kërkojë konsensus politik ndërmjet palëve<sup>5</sup>. Por në krahun tjetër, delegacionit përfaqësues të Shqipërisë në konferencën e parë ndërqeveritare i mungoi opozita.

“Hallet e kusuret e politikës” kanë rënduar gjithmonë mbi Shqipërinë, nëse e rikujtojmë marsin e 2015, në takim të pestë “të Dialogut të Nivelit të Lartë”<sup>6</sup> midis Shqipërisë dhe BE, Komisioneri i BE për Zgjerimin Johannes Hahn, vuri në dijeni Shqipërinë asokohe për vendosjen e një date fillestare për negociatat e pranimit për të filluar duhej të plotësoheshin dy kushte, e njëri prej tyre ishte që qeveria duhej të rihapte dialogun politik me opozitën parlamentare.

Bashkëpunimi i thellë politik, real dhe dialogu konstruktiv shumëpalësh është thelbësor për të jetësuar dëshirën e qytetarëve shqiptarë për integrimin e plotë në familjen europiane.

Shqipëria e ka humbur shpeshherë trenin e saj për shkak të antagonizmit dhe polarizimit politik dhe mungesës së vullnetit politik të palëve. Shqipëria është një rast i paprecedent sa i takon kohëzgjatjes së hapjes së negociatave pas marrjes së statusit si vend kandidat, 8 vite janë dashur Shqipërisë kur Serbisë dhe Malit të Zi janë dashur vetëm dy vite, ku përjashtim bën vetëm Maqedonia e Veriut që ka pasur një mosmarrëveshje të hapur prej vitesh me palën Greke.

### **Mekanizmat për përfshirjen e Shoqërisë Civile**

Rëndësia e bashkëpunimit me shoqërinë civile është shprehur qartë në nenin 11 të Traktatit të Lisbonës<sup>7</sup> në të cilin përmendet rëndësia e dialogut civil, si dhe me kushtëzimin nga BE-ja për vendet e Ballkanit Perëndimor që të stimulojnë këtë dialog në mënyrë që shoqëria civile të ushtrojë rolin e saj në këtë proces. Shoqëria civile është aktor kyç në monitorimin, konsultimin dhe vlerësimin e veprimeve të qeverisjes qendrore dhe asaj lokale në kuadër të procesit të integritit evropian

<sup>5</sup> Faqja zyrtare e Komisionit Evropian.

<sup>6</sup> Faqja zyrtare e Komisionit Evropian.

<sup>7</sup> Traktati i Lisbonës.

të vendit. Procesi i negociatave që përkthehet në negocimin e kapitujve të Acquis së BE mes dy palëve: asaj europiane me atë shqiptare, kërkon përfshirjen e të gjithë aktorëve të shoqërisë, ku shoqëria civile duhet të jetë pjesë në këshillimin, diskutimin dhe informimin gjatë kësaj kësaj faze, si dhe të ketë rolin e saj monitorues dhe vlerësues me qëllim shtyrjen e procesit sa më para.

Për Komisionin Evropian progresi i Shqipërisë në kontekstin e llogaridhënies dhe transparencës konsultimi me shoqërinë civile dhe grupet e interesit ka mbetur formal dhe i kufizuar në ndikimin e tij (Komisioni Evropian, 2021, fq.4).

Në vitin 2015 u miratua Ligji Nr.119/2015, "Për Krijimin dhe Funksonimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile", me synimin për të krijuar një urë dialogu midis qeverisë dhe OSHC-ve. Këshilli Kombëtar për Shoqërinë Civile përbëhet nga 27 anëtarë, prej të cilëve 13 janë përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, 13 janë përfaqësues të institucioneve publike, dhe 1 përfaqëson komunitetin e biznesit.<sup>8</sup> Bazuar në ligjin Nr.119/2015, KKSHC-ja mbledhet, të paktën, 3 herë në vit, si dhe kur kërkohet nga 1/3 e anëtarëve të saj. Në Nenin 8, Pika 6 evidentohet se një nga detyrat e Këshillit përcaktohet si organi që jep opinione drejtuar Këshillit të Ministrave për përcaktimin e prioritetëve, në lidhje me fondet e Bashkimit Evropian apo institucioneve të tjera ndërkombëtare për Shqipërinë, që ndikojnë zhvillimin e shoqërisë civile.<sup>9</sup>

Në burimet zyrtare online të Këshillit apo organeve të tjera zyrtare që sipas ligjit janë pjesë e Këshillit **nuk ka të dhëna** mbi rezultatet e takimeve të zhvilluara dhe mbi rolin që ka pasur ky këshill në procesin e integritit apo përcaktimin e prioritetëve në lidhje me fondet e Bashkimit Evropian apo më gjerë, si dhe nuk ka publikim të ndjekjes së konsultimeve që qeveria duhej të zhvillonte me Këshillin në mënyrë periodike.

<sup>8</sup> Ligji Nr.119/2015, "Për Krijimin dhe Funksonimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile".

<sup>9</sup> Ligji Nr.119/2015, "Për Krijimin dhe Funksonimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile".

## Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian

Një tjetër strukturë e themeluar me qëllim përfshirjen e shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë është Këshilli Kombëtar për Integrimin Evropian, që shërben si struktura më e lartë këshilluese e Kuvendit të Shqipërisë për integrimin evropian.

Në Ligjin Nr. 15/2015 "Për Rolin e Kuvendit në Procesin e Integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian", parashikohet informimi i publikut për ecurinë e etapave të procesit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile të përfshirë në këtë proces.<sup>10</sup> Ky organizëm ka synim promovimin dhe garantimin e bashkëpunimit gjithëpërfshirës mes forcave politike, institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile në procesin vendimmarrës që lidhet me çështje të integritit evropian.

Krijimi i Këshillit Kombëtar u iniciua në adresim të rekomandimit të Dialogut të Nivelit të Lartë BE-Shqipëri, për ngritjen e një strukture gjithëpërfshirëse për integrimin evropian, e cila do të garantonte zhvillimin e një dialogu politik konstruktiv e të qëndrueshëm dhe do të siguronte gjithëpërfshirjen në realizimin e reformave dhe detyrimeve të anëtarësimit.<sup>11</sup>

Qeveria shqiptare është zotuar për përfshirjen e këtij mekanizmi konsultiv me qëllimin që ky mekanizëm do të garantonte përfshirjen e shoqërisë civile në proceset reformuese lidhur me procesin e integritit në Bashkim Evropian.

## Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian

Një tjetër mekanizëm pjesë e Këshillit është Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian ngritur në bazë të Urdhrit të Kryeministrit nr. 113,

<sup>10</sup> Ligji Nr. 15/2015 "Për Rolin e Kuvendit në Procesin e Integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian".

<sup>11</sup> Urdhër Nr.113, datë 30.08.2019 Për Format e Pjesëmarrjes, Funkionimin dhe Strukturën Institucionale Të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian.

datë 30.08.2019,<sup>12</sup> ku për çdo kapitull të acquis të BE-së ngrihen tryezat e këshillimit me grupet e interesit.

Nëpërmjet Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian nga ana e qeverisë synohet informimi, konsultimi, komunikimi dhe përfshirja e shoqërisë civile, grupeve të interesit, botës akademike, dhe pushtetit vendor në procesin e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian organizohet me dy nivele përfaqësimi. Së pari, Bordi Drejtues, i cili drejton Platformën e Partneritetit për Integrimin Evropian. Bordi Drejtues kryesohet nga Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe ka në përbërje të tij 15 anëtarë (ndër të cilët Zëvendësministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Kryenegociatori, zyrtar të nivelit drejtues të MEPJ dhe përfaqësues nga shoqatat e organeve të pushtetit vendor, shoqërisë civile, të komunitetit të biznesit, shoqatave të punëmarrësve dhe botës akademike). Së dyti, kemi dhe 33 Tyeza të Diskutimit dhe Këshillimit, të cilat krijohen në mënyrë analoge me kapitujt e acquis të Bashkimit Evropian.<sup>13</sup>

Në anën tjetër, ky organ që shërben si një mekanizëm konsultativ ka disa kufizime të cilat çënojnë gjithëpërfshirjen dhe efikasitetin e plotë të tij. Së pari, OSHC-të që janë anëtare janë të bazuara dhe funksionojnë në Tiranë dhe nuk ka asnjë OSHC rajonale apo organizatë rinore që të garantojë përfshirjen e perspektivës së të rinjve në proces. Po ashtu, në këtë organ ka vetëm një përfaqësues nga universiteti publik i Tiranës dhe nuk ka përfaqësues nga universitete të tjera publike dhe private të Tiranës apo qarqeve të tjera të Shqipërisë, perspektivat dhe kontributet e të cilëve mungojnë (ACPD & EMA, 2022).

OSHC-të lokale nga rajone të tjera të vendit përpos Tiranës apo organizatat rinore janë të papërfaqësuar ose shumë pak të përfaqësuar, kjo lidhur dhe më vështirësitë dhe mungesën e informacionit që ato hasin për tu përfshirë e për tu bërë pjesë e

<sup>12</sup> Urdhër Nr.113, datë 30.08.2019 Për Format e Pjesëmarrjes, Funkionimin dhe Strukturën Institucionale Të Platformës së Partneritetit për Integrimin Evropian.

<sup>13</sup> Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.

mekanizmave të tilla. Është e rëndësishme që OSHC-të lokale dhe rinore të përfshihen, pasi procesi i negocimit të kapitujve me BE kërkon zbatimin dhe implementimin e EU Acquis në një masë të madhe në nivel lokal.

Po ashtu, sa i takon mbledhjeve në të shumtën e rasteve debati përqendrohet vetëm në nivel politik, ku anëtarët e Këshillit, ndërkohë që janë edhe anëtarë të Kuvendit, e zhvendosin vëmendjen e mbledhjes në retorikën politike. Kjo sjell një shmangie nga qëllimi kryesor që ka ky organizëm duke mos i lënë hapësirë të mjaftueshme për një diskutim objektiv dhe konstruktiv, që si pasojë sjell një kufizim të rekomandimeve dhe komenteve thelbësore gjatë këtyre takimeve (ACPD & EMA, 2022).

Në **Raportin e Komisionit Evropian** ceket qartë se integrimi në BE rënditet më ulët në prioritetet e përcaktuara në programin e qeverisë së re të paraqitur në Shtator 2021. Konsultimet dhe përcaktimi i gjendjes për çështjet që lidhen me BE-në vazhduan ndërmjet aktorët qeveritarë dhe parlamentarë me aktorët përkatës, përfshirë shoqërinë civile, në kuadër të Këshillit Kombëtar për Integrimin Evropian, **por mbeten josistematike** (Komisioni Evropian, 2021, fq.11).

Një tjetër problematikë mund të konsiderohet se përtej raportimit të aktiviteteve dhe publikimit të përmbledhjeve të aktiviteteve të organizuara nga Këshilli në Raportin Vjetor të Këshillit Kombëtar të Integritimit Evropian për vitin 2021<sup>14</sup>, nuk ka konkluzione të qarta për mënyrën se si propozimet apo rekomandimet nga shoqëria civile gjatë këtyre aktiviteteve janë përkthyer në punën e parlamentit kombëtar ose komisioneve parlamentare përkatëse ose të vetë Këshillit.

<sup>14</sup> Kuvendi i Shqipërisë. (2021). Raporti Vjetor i Këshillit Kombëtar të Integritimit Evropian për vitin 2021.

## Të rinjtë dhe organizmat për përfshirjen e tyre

Të rinjtë dhe shoqëria civile janë aktorë të rëndësishëm dhe një forcë shtytëse për shoqërinë në terësi dhe qeverinë, si rrjedhojë e rolit të tyre të pazëvendësueshëm për të ardhmen e vendit. Të rinjtë, organizatat rinore janë aktorë të rëndësishëm e të nevojshëm për rolin e veçantë që kanë në angazhimin në proesin dhe reformat që ndërmerren në kuadër të negociatave për anëtarësimin në BE. Është e rëndësishme që të rinjtë në Shqipëri të ndihen të përfaqësuar dhe njëkohësisht të jenë pjesë aktive e proceseve integruese si një konfirmim i perspektivës europiane dhe garanci e ecurisë dhe transparencës në procesin e negociatave me Bashkimin Evropian.

Përfshirja e të rinjve duhet të realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes politike të të rinjve veçanërisht në nivelin lokal dhe ti kushtohet vëmendja e duhur kontributit dhe aspiratave të tyre. Të rinjtë duhet të jenë pjesë e sistemit të vendimmarrjes, jo si një fasadë dekoruese por të kenë hapësirën dhe mundësinë e tyre të japin kontributin dhe ndajnë aspiratat e tyre. Një dritare e vlefshme për të rinjtë për të dhënë kontributin e tyre është nëpërmjet Ligjit Nr. 75/2019 “Për Rininë”, që përcakton detyrimet ligjore për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore për të ngritur Këshillat Rinor Vendor.

Këshilli Vendor i Rinisë është parashikuar në nenin 10 të ligjit Nr.75/2019 “Për Rininë”, si një organ këshillimor i cili funksionon pranë kryetarit të bashkisë, që synon përfshirjen e të rinjve në politikëbërjen e nivelit lokal, këshillon njësitë e vetëqeverisjes vendore për drejtimin e politikave dhe planeve vendore për rininë, vlerëson situatën e të rinjve dhe zbatimin e planeve dhe politikave rinore në nivel vendor si dhe propozon përmirësime të politikave vendore rinore.

Është e rëndësishme për këtë që Këshillat Rinorë Vendor të jenë aktiv në 61 Bashkitë e vendit, duke mbajtur në konsideratë se procesi i

negocimit të kapitujve me BE kërkon zbatimin dhe implementimin e EU Acquis në një masë të madhe në nivel lokal.

Një nga dokumentët më të rëndësishëm për të cilin KVR duhet të sugjerojë dhe llojë tek Kryetari i Bashkisë është garantimi që Bashkia ka një Plan Veprimi për Rininë. Përmbajtja e planit të veprimit duhet të pasqyrojë detyrime ligjore të cilat janë të përcaktuara me ligj.<sup>15</sup>

Secila prej 61 Bashkive të vendit duhet të zhvilloj Planin e Veprimit për Rininë si dhe të mirë përcaktoj rolin dhe kontributin e të rinjve, veçanërisht të organizatave rinore dhe atyre të shoqërisë civile. Përfshirja dhe kontributi i tyre duhet të jetë më i prekshëm dhe gjithëpërfshirës dhe ndër-disiplinorë në secilin prej kapitujve që Shqipëria do të negociojë me BE-në.

Përfshirja e të rinjve dhe organizatave rinore nuk duhet të mbetet e neglizhuar dhe larg vëmendjes së institucioneve. Është përcaktuese për ecurinë e Shqipërisë në negociatat me BE që kontributi dhe potenciali i të rinjve të zgjerohet dhe kanalizohet jo vetëm në disa kapituj specifik të tillë si 19 “Politika sociale dhe punësimi” dhe 26 “Arsimi dhe kultura”, por më gjerë në kapitujt e tjerë dhe fusha të tjera veprimi ku kontributi tyre mund të vlejë dhe të ketë një rol kyç në monitorimin dhe përparimin e procesit. Agjenda integruese e Shqipërisë në BE duhet të zgjerohet përmes një platforme e cila duhet të përfshijë të gjithë aktorët, veçanërisht të rinjtë e organizata rinore dhe shoqërinë civile, apo aktorë të tjerë kyç të cilët luajnë një rol kyç në monitorimin e këtij procesi, si dhe të vepruarit në një linjë të agjendës së jashtme duhet të jetë kryefjala e çdo nisme me qëllim integrimin e plotë në BE.

<sup>15</sup> Ligji Nr. 75/2019 “Për Rininë”.



## Konkluzione

Përfshirja e shoqërisë civile, të rinjve apo organizatave rinore duhet të jetë kapilare dhe e vazhdueshme në konsultimin dhe monitorimin e proceseve të ndërmarra në kuadër të anëtarësimit në BE. Qeveria duhet të përmirësojë dialogun e saj me shoqërinë civile dhe të promovojë më qartë mjetet ekzistuese të pjesëmarrjes me shoqërinë civile, të rinjtë dhe qytetarët. Institucionet shtetërore duhet t'i bëjnë këta mekanizma efektivë përmes protokolleve transparente të pjesëmarrjes dhe njohjes së kontributit të OSHC-ëve si partner legjitim në proces.

Sfida e integritimit europian e vendit është sfidë e gjithë shoqërisë mbi të gjitha e qeverisë dhe institucioneve të vendit për ta çuar procesin më tej. Kjo sfidë kërkon profesionistë të aftë për t'u ballafaquar me procesin jo pak të vështirë të negociatave të anëtarësimit, dhe realizimin e këtij objekti madhor të vendit tonë, i cili bëhet edhe më i vështirë në kushtet aktuale të largimit të të rinjve dhe trurit të vendit në masë. Ndaj përfshirja e palëve të treta në këtë proces mund të garantojë një ecuri më të shpejtë dhe produktive për procesin e anëtarësimit në BE.

## Rekomandime

- Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian duhet të zgjerojë më tej përfshirjen e aktorëve të rëndësishëm në këtë proces OSHC-të lokale nga rajone të tjera të vendit përpos Tiranës apo organizatave të papërfaqësuar, pasi procesi i negociimit të kapitujve me BE kërkon zbatimin dhe implementimin e EU Acquis në një masë të madhe në nivel lokal.
- Me qëllim rritjen e transparencës dhe përfshirjen e palëve të interesit, Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian duhet të ofrojë dhe mundësojë aksesin për të gjithë palët e interesuara me përmbledhjet e takimeve dhe raportet që prodhohen gjatë Tavolinave të Diskutimit dhe Konsultimeve.
- Platforma e Partneritetit për Integrimin Evropian duhet të paraqesë në interes të opinionit publik konkluzione të qarta se si rekomandimet dhe kontributet e marra gjatë këtyre aktiviteteve janë përkthyer në punën e parlamentit kombëtar ose komisioneve parlamentare përkatëse ose të vetë Këshillit.
- Për Komisionin Evropian (2021) progresi i Shqipërisë në kontekstin e llogaridhënies dhe transparencës konsultimi me shoqërinë civile dhe grupet e interesit ka mbetur formal dhe i kufizuar në ndikimin e tij.
- Qeveria duhet të rrisë kapacitetin e burimeve njerëzore dhe financiare të dedikuara për anëtarësimin në BE në të gjithë administratën.
- Përfshirja e të rinjve dhe organizatave rinore nuk duhet të mbetet e neglizhuar dhe larg vëmendjes së institucioneve. Është përcaktuese për ecurinë e Shqipërisë në negociatat me BE që kontributi dhe

potenciali i të rinjve të zgjerohet dhe kanalizohet jo vetëm në disa kapituj specifik të fillë si “Politika sociale dhe punësimi” apo “Arsimi dhe kultura”, por më gjerë në kapitujt e tjerë dhe fusha të tjera veprimi ku kontributi tyre mund të vlejë dhe të ketë një rol kyç në monitorimin dhe përparimin e procesit.

- Për të vënë në punë energjinë dhe aspiratat e të rinjve shqiptar, secila prej 61 Bashkive të vendit duhet të zhvilloj Planin e Veprimit për Rininë si dhe të mirë përcaktoj rolin dhe kontributin e të rinjve, veçanërisht të organizatave rinore si palë kryesore të interesit.
- Qeveria duhet të intensifikojnë dhe diversifikojnë mjetet e komunikimit me qëllim për të informuar dhe për të promovuar procesin e anëtarësimit dhe platformat ekzistuese për përfshirje të cilat në thelb kanë qëllim të nxisin pjesëmarrjen e aktorëve të rëndësishëm si të rinjtë apo shoqëria civile në procesin e anëtarësimit.

## Referenca

Ligji Nr. 75/2019 "Për Rininë".

Ligji Nr. 15/2015 "Për Rolin e Kuvendit në Procesin e Integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian".

Ligji Nr.119/2015 "Për Krijimin dhe Funksonimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile"

Urdhër Nr.113, datë 30.08.2019 Për Format e Pjesëmarrjes, Funksonimin dhe Strukturën Institucionale Të Platformës së Partneritetit për Integritimin Evropian. Aksesuar në: <http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2020/04/3.-Urdher-i-KM-no.113-dt.30.08.2019-PPIE.pdf>

Traktati i Lisbonës.

Aksesuar në:

[https://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:2bf140bf-a3f8-4ab2-b506-fd71826e6da6.0023.02/DOC\\_1&format=PDF](https://eur-lex.europa.eu/resource.html?uri=cellar:2bf140bf-a3f8-4ab2-b506-fd71826e6da6.0023.02/DOC_1&format=PDF)

Komisioni Evropian. (2021). Raporti për Shqipërinë 2021.

Aksesuar në: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2021\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2021_en)

Kuvendi i Shqipërisë. (2021). Raporti Vjetor i Këshillit Kombëtar të Integritit Evropian për vitin 2021.

Aksesuar në: <https://www.parlament.al/Files/Integrimi/raport2021.pdf>

EU Policy Hub. (2021). MANUAL I AKTIVIZMIT TË KËSHILLAVE VENDOR RINOR (Pjesëmarrja e të rinjve në Këshillat Vendor Rinor dhe Rrjetëzimi i tyre).

Aksesuar në: <https://www.eupolicyhub.eu/wp-content/uploads/2021/11/Manuali-Rlact-Final.pdf>

Albanian Center for Population and Development (ACPD) & European Movement in Albania (EMA). (2022). Consultation process in Albania under EU integration process Policy Paper what role for civil society. National Resource Centre for Civil Society in Albania Platform.

Aksesuar në: <http://em-al.org/en/6337-2/>

EMA. (2020). Përfshirja e shoqërisë civile në procesin e integritit evropian.

Aksesuar në: [https://resourcecentre.al/wp-content/uploads/2021/04/Dokument-Politikash\\_Perfshirja-e-shoqerise-civile-ne-procesin-e-integritit-europian-2.pdf](https://resourcecentre.al/wp-content/uploads/2021/04/Dokument-Politikash_Perfshirja-e-shoqerise-civile-ne-procesin-e-integritit-europian-2.pdf)

Këshilli i Bashkimit Evropian. (2003). Presidency Conclusions - Copenhagen, 12 and 13 December 2002. Aksesuar në:

<https://www.consilium.europa.eu/media/20906/73842.pdf>

Faqja zyrtare e Komisionit Evropian.

Aksesuar në: [https://neighbourhood-](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/news/speech-commissioner-oliver-varhelyi-19-july-2022-inaugural-meeting-screening-process-albania-and-2022-07-20_en)

[enlargement.ec.europa.eu/news/speech-commissioner-oliver-varhelyi-19-july-2022-inaugural-meeting-screening-process-albania-and-2022-07-20\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/news/eu-albania-5th-high-level-dialogue-2015-03-24_en)

Aksesuar në: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/news/eu-](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/news/eu-albania-5th-high-level-dialogue-2015-03-24_en)

Faqja zyrtare e Këshillit të Bashkimit Evropian

Aksesuar në: [https://www.consilium.europa.eu/en/meetings/international-](https://www.consilium.europa.eu/en/meetings/international-summit/2022/06/23/)

[summit/2022/06/23/](https://www.consilium.europa.eu/en/policies/enlargement/)

Faqja zyrtare e Kryeministrisë.

Aksesuar në: <https://kryeministria.al/neesroom/sot-fitoi-shqiperia/>

Platforma zyrtare e Këshillimit Kombëtar

Aksesuar në:

[https://keshillimikombetar.al/pdf/Rezultatet%20e%20Keshillimit%20Kombetar](https://keshillimikombetar.al/pdf/Rezultatet%20e%20Keshillimit%20Kombetar%202.pdf)

[2.pdf](https://keshillimikombetar.al/)

Faqja zyrtare e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme

Aksesuar në: [http://integrimi-ne-](http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/strukturat/platforma-e-partneritetit-per-integrimin-evropian/)

[be.punetejashtme.gov.al/strukturat/platforma-e-partneritetit-per-integrimin-](http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/strukturat/platforma-e-partneritetit-per-integrimin-evropian/)

Faqja zyrtare e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Aksesuar në: [https://financa.gov.al/behu-pjese-e-platformes-se-](https://financa.gov.al/behu-pjese-e-platformes-se-partneritetit/)

[partneritetit/](https://financa.gov.al/platforma-e-partneritetit-per-integrimin-evropian/)

Aksesuar në: [https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/01-Urdhri-](https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2021/10/01-Urdhri-i-KM-Nr.113-dt.30.08.2019-PPIE.pdf)

Heinrich Böll Foundation.

Aksesuar në: [https://eu.boell.org/en/2022/07/07/nee-day-europe-not-](https://eu.boell.org/en/2022/07/07/nee-day-europe-not-bulgaria)

European Western Balkans.

Aksesuar në: [https://europeanwesternbalkans.com/2019/12/10/rutte-we-](https://europeanwesternbalkans.com/2019/12/10/rutte-we-are-not-against-eu-enlargement-albania-is-not-ready-to-open-negotiations/)

The Guardian.

Aksesuar në: <https://www.theguardian.com/world/2018/may/18/no-time-soon-eu-dashes-membership-hopes-of-balkan-states-enlargement-sofia-summit>

Reuters

Aksesuar në: <https://www.reuters.com/world/europe/albania-seeks-pursue-eu-membership-separately-n-macedonia-2022-04-07/>

Evropa e Lirë.

Aksesuar në: <https://www.evropaelire.org/a/31911350.html>

Euronews.al

Aksesuar në: <https://euronews.al/kryesore/2022/06/21/presim-nje-tjeter-jo-rama-diskutim-me-vucic-dhe-kovacevskin-per-samitin-e-be/>

Agjencia Telegrafike Shqiptare. (2022).

Aksesuar në: <https://ata.gov.al/2022/03/23/keshillimi-kombetar-rama-plotesohen-rreth-487-mije-pyetesore/>

Tanjug.rs

Aksesuar në: <http://www.tanjug.rs/full-view.aspx?izb=739377>

Euractiv.

Aksesuar në: <https://www.euractiv.com/section/global-europe/news/serbia-albania-north-macedonia-could-boycott-eu-summit-vucic-say/>

Politico.eu

Aksesuar në: <https://www.politico.eu/article/western-balkan-leader-attend-eu-summit-after-threat-boycott/>



#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA  
QYTETARE



NED

NATIONAL  
ENDOWMENT  
FOR  
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

[www.qeverisja.qq.com.al](http://www.qeverisja.qq.com.al)